

GUIDË BURIMORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI GJINOR NË SEKTORIN EKONOMIK



GUIDË BURIMORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI GJINOR NË SEKTORIN EKONOMIK



Kjo Guidë është përgatitur me mbështetjen e Njesisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Zyra Shqipëri.

Mendimet dhe pikëpamjet në këtë dokument nuk përbëjnë detyrimisht mendimet dhe pikëpamjet e UN Women ose Kombeve të Bashkuara

Botuar më Nëntor, 2012

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Përgatitja e kësaj Guide u mundësua në sajë të kontributit të cmuar të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe vecanërisht përkushtimit të Zj.Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të përgatitur një material me informacione të vlefshme dhe praktike jo vetëm për KMD, por për çdo institucion qendror, njësi të pushtetit vendor, organizatë të shoqërisë civile, sindikatë, dhomë tregtie dhe industrie, operator biznesi, dhe çdo aktor tjetër që punon dhe kontribuon për arritjen e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik.

Mirënjohje e vecantë i njihet stafit të UN Women, Tiranë dhe vecanërisht Zj.Fiorela Shalsi, Kordinatore Kombëtare Programi, për instruksionet e vazhdueshme dhe ofrimin e ekspertizes teknike në hartimin e kësaj guide.

Kjo guidë është përgatitur në sajë të bashkëpunimit të UN Women me ekspertet ligjore Zj. Klotilda Bushka (Ferhati) dhe Zj. Aulona Hazbiu, që realizuan punën kërkimore dhe hartimin e Guidës, si një manual praktik pune për çdo person të interesuar në adresimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik.

PËRMBAJTJA

I.	Hyrje.....	fq. 5
II.	Të kuptojmë diskriminimin	fq. 6
III.	Kuadri Ligjor për barazinë gjinore në Shqipëri.....	fq. 8
IV.	Mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi.....	fq. 15
V.	Indikatorët për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik.....	fq. 22
VI.	Raste studimore të Komisionerit Kundër Diskriminimit.....	fq. 24
VII.	Praktika te mira.....	fq. 26
VIII.	Bibliografia.....	fq. 40

Lista e Aneksëve

Annex 1 – Indikatorët për monitorimin dhe raportimin e fuqizimit ekonomik të grave	fq. 41
Annex 2 – Lista e kontakteve për Organizata të Shoqërisë Civile	fq. 47
Annex 3 – Lista e kontakteve për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë	fq. 60
Annex 4 – Lista e Sindikatave	fq. 63
Annex 5 – Lista e NjësiveVendore	fq. 64
Annex 6 – Lista e kontakteve me Institucionet Arsimore	fq. 73
Annex 7 – Lista e kontakteve të Medias	fq. 76

I. Hyrje

Kjo Guidë burimore përbën një manual orientues për çështje që lidhen me diskriminimin gjinor në sektorin ekonomik.

Qëllimi i saj është të ofrojë sa më shumë informacione praktike për të kuptuar sjelljet diskriminuese, format e shfaqjes së tyre, rregullimet ligjore që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi, adresimin e diskriminimit gjinor, mekanizmat ligjorë të mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe instrumentat e monitorimit dhe raportimit të sjelljeve diskriminuese me bazë gjinore në sektorin ekonomik.

Në hartimin e kësaj Guide është mbajtur parasysh që forma dhe përmbajtja e saj të jenë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin.

Në këtë Guidë trajtohen nocionet që lidhen me diskriminimin dhe kryesisht me diskriminimin gjinor, aktet ligjore ndërkombëtare dhe lokale që garantojnë barazinë gjinore dhe ofrimin e shanseve të barabarta, mekanizmat vendas për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor si dhe mjete dhe metoda për të (i) rritur ndjeshmërinë e të gjithë aktorëve shtetërore, publikë, privatë, sociale dhe ekonomike kundër diskriminimit për arritjen e barazisë gjinore; (ii) për të ngritur, adresuar, monitoruar dhe raportuar çështje të diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik; si dhe (iii) për të intensifikuar dhe koordinuar iniciativa kundër diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik, të aplikueshme nga KMD, institucionet shtetërore, publike dhe private, organizatat e shoqërisë civile, operatorët e biznesit, sindikatat e cdo subjekt apo ent tjetër publik apo privat që tregon interes për arritjen e drejtësisë sociale nëpërmjet ofrimit të shanseve të barabarta dhe respektimit të barazisë gjinore.

II. Te kuptojme diskriminimin

Përkufizimi i diskriminimit

Diskriminim konsiderohet çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë preferimi, me qëllim të mohimit ose refuzimit të të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes. Diskriminimi është mohim i parimit të barazisë për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Elementët për të kuptuar diskriminimin

Sjellje

Akte, veprime ose mosveprime, të cilat konsiderohen si diskriminuese, si dallimi, përjashtimi, kufizimi dhe preferimi.

Shkaqe

Karakteristika që nxisin sjelljet që konsiderohen diskriminuese si raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare/etnike, gjinia, moshë, integriteti fizik etj.

Qëllimi

Qëllimi i sjelljeve që konsiderohen si diskriminuese është t'i mohojë individëve gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore.

Diskriminimi pozitiv

Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur më sipër, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim. Kjo masë është e përkohshme dhe ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Diskriminimi Gjinor

Gratë kanë qenë të detyruara ndër shekuj të luftojnë për njohjen dhe pranimin e tyre si qenie të plotë njerëzore si dhe të drejtave të tyre themelore, por fatkeqësisht, kjo luftë ende nuk ka përfunduar. Edhe pse situata e tyre është përmirësuar në shumë sfera të jetës shoqërore, struktura të ndryshme shoqërore dhe paragjykimet e tyre janë ato që ende po pengojnë implementimin e plotë dhe të menjëhershëm të të drejtave të grave.

Të gjithë ata që kanë përjetuar dhe ende përjetojnë diskriminim nuk kanë mundur dhe ende nuk mund të gëzojnë në tërësi të drejtat e tyre elementare kushtetuese.

Gjinia është një kategori e dobishme për t'u analizuar, pasi na ndihmon të kuptojmë se si gratë dhe burrat në shoqëri marrin përgjegjësi, role dhe pozita të ndryshme.

Përfshirja e analizave gjinore në teorinë dhe praktikën e të drejtave të njeriut, është mjet për të ndërgjegjësuar dhe për të rritur sensibilitetin e kujtdo mbi dallimet mes grave dhe burrave në shoqëri dhe për mënyrat specifike të shkeljes së të drejtave të grave.

Prandaj, duhet promovuar dhe ndërgjegjësuar opinionin publik për ndjeshmërinë gjinore, me qëllim të arritjes së të drejtave të barabarta për të gjithë, pa dallim gjinie, ngjyre, race dhe feje.

Diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim të bazuar në gjini, që ka për efekt ose qëllim të kompromentojnë ose të asgjësojnë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendje e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër, (neni 1 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave “CEDAW”).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji themeltar në vendin tone, garanton parimin e barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit, (neni 18). Në sajë të këtij parimi universal, burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, *de jure* trajtohen njësoj, dhe si pasojë kanë të drejta edhe detyrime të njëjta.

Parimi i barazisë përpara ligjit sanksionon se cdo shtetas ka të drejta dhe detyrime të njëjta, por në jetën e përditshme kjo barazi nuk është reale. Barazia reale mund të arrihet vetëm nëse nga zbatimi korrekt i barazisë formale që garantohet prej ligjit, arrihen rezultate të barabarta dhe përfitime të barabarta si për burrat ashtu dhe për gratë.

Ofrimi i shanseve të barabarta për cdo individ është i një rëndësie themelore dhe duhet garantuar domosdoshmërisht me ligj. Vetë ligji duhet të parashikojë mekanizma për zbatimin efektiv të tij, me qëllim që efektet e tij të ndihen realisht prej cdo individi.

III. **Kuadri Ligjor për Barazinë Gjinore**

Perpjekjet globale për arritjen e barazisë gjinore

CEDAW - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Pabarazia në shumë fusha të jetës së përditshme, mungesa e pavarësisë ekonomike dhe diskriminimi ndaj tyre ishin ato rrethana që shtynë Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) që gjatë viteve 1970, të vendosin për lançimin e projektit **“Dekada e Kombeve të Bashkuarapër Gratë: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja”**. Në vitin 1979, me miratimin e Konventës “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (CEDAW), projekti “Dekada e Kombeve të Bashkuarapër Gratë: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja” arriti kulminacionin e saj.

Kjo Konventë është instrumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe njihet edhe si *“Kushtetuta e Gruas”*. Për herë të parë, CEDAW, parashikon të drejta civile, politike dhe ekonomike, sociale e kulturore, duke bashkuar kështu dy kategori të të drejtave, të cilat përndryshe janë të ndara, duke njohur gratë si qenie të plota njerëzore.

“Diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim të bazuar në gjini, që ka për efekt ose qëllim të kompromentojnë ose të asgjësojnë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendje e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.” (neni 1 i CEDAW).

CEDAW gjithashtu obligon shtetet anëtare:

- Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme parimin e barazisë mes grave dhe burrave;
- Të sigurojnë zbatimin efektiv të parimit të barazisë;
- Të miratojnë masa ligjore dhe masa të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe sanksione nëse është nevoja, për ndaljen e çdo diskriminimi ndaj grave;
- Të vendosin baza të barabarta për mbrojtje e të drejtave të grave dhe burrave;
- Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të arrijnë që autoritetet publike dhe institucionet publike t’i përmbahen këtij detyrimi;
- Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin të cilin e ushtron ndonjë person, organizatë ose çfarëdo ndërmarrje ndaj grave;
- Të anullojnë të gjitha dispozitat penale që përbëjnë ndonjë diskriminim ndaj grave;

- Të sigurojnë zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave mbi bazat e barazisë me burrat, me qëllim që t'u garantojnë atyre në mënyrë të barabartë ushqimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut e të lirive themelore;
- Të ndryshojnë skemat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe gruas;
- Të arrijnë zhdukjen e paragjytimeve dhe çfarëdo praktike tjetër zakonore, që mbështetet në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njerës apo tjetrës gjini, ose stereotipe të rolit të burrit dhe gruas;
- Të sigurojnë që edukimi familjar të përfshijë kuptimin e drejtë të maternitetit si funksion social dhe njohjen e përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas për përkujdesjen ndaj rritjes së fëmijëve dhe zhvillimit të tyre, duke bërë të qartë se kusht parësor në të gjitha rastet është interesi i fëmijëve;
- Të marrin gjitha masat e përshtatshme për të zhdukur të gjitha format e trafikimit të grave dhe ndalimin e prostitucionit të grave.
- Të sigurojnë votimin e grave në të gjitha zgjedhjet dhe referendimet publike, si dhe mes tjerash të jenë të zgjedhshme në të gjitha këto organe;
- T'u japin grave të drejta të barabarta me burrat në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë;
- T'u sigurojnë grave të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimimit.

Konventa rregullon çështjet nga jeta private edhe ajo publike e grave. Disa dispozita kanë të bëjnë me rolin e grave në familje dhe shoqëri, nevojën për ndarjen e përgjegjësisë brenda familjes dhe nevojën urgjente për implementimin e ndryshimeve në sistemet sociale dhe kulturore, të cilat i atribuohen pozitës së varur të grave. Njohja e të drejtave të grave në nivel global mund të bëhet vetëm përmes këtyre ndryshimeve themelore. Kur një shtet bëhet palë e CEDAW-it, ai obligohet që me të gjitha mjetet e nevojshme dhe pa kurrefarë vonese ta respektojë politikën e eliminimit të diskriminimit dhe çdo akti tjetër diskriminues ndaj grave.

Më 06.10.1999, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me një vendim historik për gratë, miratoi “**Protokolin Opsional të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**”, me 21 nene, dhe u bëri thirrje të gjitha shteteve palë të Konventës, të bëhen sa më parë palë edhe të këtij instrumenti. Ky Protokoll ofron mundësinë që Komitetit të Konventës t'i adresohen ankesa individuale të bazuara në CEDAW. Deri në prill të vitit 2003 “Protokolin Opsional”, e kanë nënshkruar 75 shtete, deri sa tashmë e kanë ratifikuar 50 shtete (përfshire dhe Republikën e Shqipërisë).

Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave kishin filluar edhe më parë. Më poshtë në radhë kronologjike, listohen, disa nga aktet me domethenese për këtë qëllim:

- 1789** Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër nga *Olympe de Gouges*;
- 1888** Themelimi i Këshillit Ndërkombëtar të Grave;
- 1921** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve dhe Protokoli Shtesë;
- 1933** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave të moshës madhore;
- 1950** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Eksploatimit të tjerëve përmes Prostitucionit;
- 1953** Konventa për të Drejtat Politike të Grave;
- 1957** Konventa për Shtetësinë e Grave të martuara;
- 1962** Konventa për Pajtim në Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave;
- 1967** Deklarata për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
- 1975** Konferenca e parë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Meksiko Siti);
- 1976** Fillimi i Dekadës së OKB-së për Gratë: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja;
- 1979** Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);
- 1980** Konferenca e dytë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Kopenhagë);
- 1985** Konferenca e tretë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Nairobi);
- 1985** Miratimi i Strategjive të Nairobit të Parapara për Avancimin e Grave deri në vitin 2000;
- 1995** Konferenca e katërt Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Pekin)
- 1998** Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale;
- 2000** Protokoli për Parandalimin, Ndalimin dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, në veçanti të Grave dhe Fëmijëve, si plotësim i Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional;
- 2000** Takimi i 23 të Special i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, “Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja në shekullin XXI”;

Kuadri ligjor për barazinë gjinore në Shqipëri

Aktet ndërkombëtare të përmendura më sipër janë përqafuar nga vendi ynë dhe si pasojë në Shqipëri, janë bërë përpjekje dhe arritje në miratimin e dispozitave ligjore që garantojnë barazinë gjinorë në sektorë të ndryshëm.

Sic është parashtruar më sipër, parimi universal, që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, trajtohen njësoj *de jure*, dhe si pasojë kanë të drejta edhe detyrime të njëjta është e percaktuar në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve ndërkombëtarë që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe vecanërisht me sanksionimin e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë behet pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 122/2 të Kushtetutës, *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to”*.

Në cilësinë e shtetit anëtar të OKB, që në vitin 1993, Shqipëria ka ratifikuar Konventën "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave", ("CEDAW"), e cila ka hyrë në fuqi, më 11.05.1994. Që prej vitit 2003 Republika e Shqipërisë ka aderuar edhe në "Protokollin Opsional" të kësaj Konvente.

Komiteti i CEDAW-t i ka rekomanduar Shqipërisë rishikimin e legjislacionit penal për të bërë të dënueshme dhunen në familje, miratimin e ligjeve të tjera të posacme për dhunen në familje që të parashikojnë udhëzime gjyqësore të mbrojtjes dhe ndihmën ligjore për gratë, ngritjen dhe funksionimin e një numri të mjaftueshëm strehëzash, ngritjen e një mekanizmi shtetëror për mbledhjen sistematike të të dhënave dhe statistikave për dhunën në familje, trajnimin dhe ndergjegjësimin e strukturave të sistemit të drejtësisë për çështje të dhunës në familje si dhe ndërmarrjen e fushatave ndergjegjëse dhe edukuese për publikun¹.

Në kuadër të përpjekjeve për integrimin në Bashkimin Europian, Shqipëria dhe Bashkimi Europian kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit, ("MSA"), në datën 12.06.2006 që parashikon detyrimin e Shqipërisë për të garantuar mundësi të barabarta për punësim si dhe sigurimin e menjëhershëm të standarteve shëndetësore dhe të sigurisë në vendin e punës.

Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, (*l'acquis communautaire*), për sa i takon sanksionimin të mundësive të barabarta për punë, vecanërisht grave, është një prej detyrimeve që duhen përmbushur nga Shqipëria me qëllim pranimit të saj si shtet anëtar i Bashkimit Europian. Me vendimin nr.137, datë 13.05.2005 të Këshillit të Ministrave është miratuar *“Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimin të MSA”*, ku janë parashikuar edhe masat që duhen ndërmarrë në drejtim të arritjes së standarteve në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe në familje si dhe barazinë gjinore.

¹ Strategjia e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2007 -2010), Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta.

Ky vendim është shfuqizuar më datë 05.07.2006, me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.463, “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit”, ku përfshihen dhe masat që duhen ndërmarrë për të përmbushur arritjen e standarteve të barazisë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj (pika 1.2, pika 3.14, pika 3.14,5, pika 3.18.2).

Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar, duke bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, edhe shumë akte të tjera ndërkombëtare që sanksionojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, kryesisht masat kundër dhunës në familje, prej të cilave gjejmë me vend të përmendim “Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut” (1950), “Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (1966), “Deklarata e Mijëvjeçarit”, e nënshkruar në shtator 2000 në Mbledhjen e nivelit të lartë të OKB-së, Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (“ONP” ose “ILO” – shkurtimi në gjuhën angleze), nr. 100 “Për shpërblim të barabartë”, Konventa e ONP nr. 111 “Kundër diskriminimit”, Konventa e ONP nr. 183 “Për mbrojtjen e amësisë”, instrumenta të Këshillit të Europës, Rekomandimi (85) 4 “Për dhunën në familje”, Rekomandimi (87) 21 “Për asistencë ndaj viktimave të krimit dhe parandalimin e viktimizimit”, Rekomandimi (91) 11 “Për shfrytëzimin seksual”, etj.

Nëpërmjet këtyre akteve Shqipëria ka marrë përsipër angazhime dhe detyrime për të marrë masa konkrete me qëllim sanksionimin e të drejtave të njeriut dhe barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe eliminimin e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Në mbështetje të parimit kushtetues të barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit dhe detyrimeve të marra përsipër në baze të akteve ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar në datën 24.07.2008 Ligjin nr.9970, “Për barazinë gjinore”. Ky Ligj ka për qëllim të sigurojë mbrojtje efektive nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë; të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet; të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

Miratimi i këtij Ligji ishte paraprirë nga “Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje” (SKBGJ – DHF), së bashku me Planin e Zbatimit 2007 – 2010, miratuar më parë nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 913, datë 19.12.2007. Objektivi kryesor i zbatimit të SKBGJ-DHF, që përbën

dhe strategjinë e parë në këtë fushë, ka patur si synim forcimin e mekanizmave qeveritarë në nivel qendror dhe vendor, me qëllim zbatimin dhe monitorimin e strategjisë dhe parashikonte disa ndërhyrje, kryesisht ngritjen e strukturave të reja: Komisionet e Shanseve të Barabarta (në nivel Bashkie) dhe punonjësin/en e barazisë gjinore në çdo njësi të qeverisjes vendore.

Hartimi dhe zbatimi i SKBGJ-DHF (per vitet 2007 – 2010) shënoi hapin e parë në angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të adresuar çështje që lidheshin jo vetëm me integrimin gjinor në politikat publike, por edhe me mbrojtjen e vajzave dhe grave nga abuzimi dhe dhuna.

Si një strategji ndërsektoriale afatmesme, SKBGJ-DHF (per vitet 2007-2010) u bë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) (per vitet 2007-2013), së bashku me 15 strategji të tjera ndërsektoriale dhe 12 strategji sektoriale që mbulojnë fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social, politik dhe kulturor të vendit.

Pas përfundimit të termit të kësaj strategjie, Këshilli i Ministrave miratoi “*Strategjinë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, 2011-2015*”, dhe planin e veprimit për zbatimin e saj, (VKM nr.573, datë 16.06.2011). Në hartimin e strategjise dhe planit të veprimit per vitet 2011 – 2015, u përfshinë aktorë të shumtë të shoqërisë civile, kryesisht perfaqësues të organizatave që janë angazhuar për arritjen e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e grave nga dhuna.

Përpara miratimit të Ligjit për Barazinë Gjinore (2008), vepronin dhe jane ende ne fuqi një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995 të cilat përmbanin dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksiononin parimin e barazisë burrë-grua si: Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Familjes dhe Kodi i Punës.

Ligje të tjera të veçanta siguronin barazinë në fushën e vendimmartjes, arsimit dhe formimit profesional, siguronin mbrojtje ndaj ngacmimit seksual, mbrojtje të të drejtave riprodhuese, mbrojtje përmes sigurimeve shoqërore².

Në vitin 2010, u miratua Ligji nr.10237, datë 18.02.2010 “*Për shëndetin dhe Sigurinë në punë*”, që garantoi mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave me

² Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*” garanton të drejtën e grave të siguruara për përfitime në rast barrë lindje. Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 “*Për sistemin arsimor parauniversitar*”, Ligji nr. 8872, datë 29.03.2002 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”, Ligji për Shëndetin Riprodhues Nr. 8876, datë 04.04.2002, Ligji “*Mbi promovimin dhe mbrojtjen e ushqimit me gj*” nr. 8528, 23.09.1999, etj..

fëmijë në gji nga substancat e dëmshme në vendin e punës, në linjë me parashikimet e CEDAW dhe standarteve të BE.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjeve të mësipërmë janë miratuar nga Këshilli i Ministrave një sërë aktesh nënligjore, prej të cilave me vlerë të përmenden janë: Vendim nr.505, datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”, Vendim nr.582, datë 27.07.2011 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, Vendim nr. 397, datë 20.05.1996 ndryshuar me Vendimin nr. 185, datë 03.05.2002 “Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatëzëna dhe të amësisë”, etj.

Një hap konkret drejt arritjes së barazisë gjinore është padyshim miratimi i Ligjit nr.10221, datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që parashikoi ngritjen e një strukture të pavarur, “**Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi**” (“**KMD**”), i cili ushtron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Ky Ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatëzinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Perfshirja e gruas në skenën politike dhe fuqizimi i gruas në vendimarrje kanë qënë dhe mbeten dy aspirata të aktorëve të shoqërisë civile shqiptare dhe një sfidë dhe detyrim për qeverinë në procesin e integritetit të vendit tonë në Bashkimin Evropian. Përveç sa ishte parashikuar në Ligjin për Barazinë Gjinore (2008), progres në këtë drejtim është arritur me miratimin e Kodit Zgjedhor të vitit 2008, (Ligji nr.10019, datë 29.12.2008), ku u sanksionua se për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini.

Kjo do të thotë se për herë të parë u parashikua përfshirja e grave në listat e kandidatëve të subjekteve politike në kuotën e detyrueshme prej 30% të kësaj liste (neni 67, pika 5). Mëzbatimi i këtij detyrimi ligjor i ngarkon subjektet politike më penalitete sipas parashikimeve të nenit 175 të Kodit Zgjedhor.

Ky parashikim në Kodin Zgjedhor, pavarësisht problemeve që u hasën me zbatimin konkret të kuotës prej 30% të kandidateve gra nga ana e subjekteve

politike, solli si rezultat një rritje të numrit të grave si deputete në Kuvendin e Shqipërisë, nga 7% që ishte në vitin 2005 në 15% në vitin 2009.

iv. Mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Sic u parashtrua me sipër, KMD u krijua në bazë të Ligjit nr.10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si një institucion i pavarur që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Krijimi i këtij institucioni erdhi si iniciative e shoqërisë civile që hartoi draftin e ligjit, si rezultat i kërkesave të Bashkimit Europian për hapat që duhet të bënte Shqipëria në kuader të procesit të integritimit, dhe pasqyrooi angazhimet e shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Veprimtaria e Komisionerit realizohet nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të subjekteve që pretendojnë se janë viktimë të sjelljeve diskriminuese apo që e nxisin atë, jo vetëm nga administrata publike, por edhe nga subjektet private.

Gjithashtu, Komisioneri realizon hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji, dhe bën sondazhe dhe monitorime për nivelin e zbatimit të ligjit. Procedurat e hetimit administrativ pasohen nga rekomandime, dhe në rast të moszbatimit të tyre vendosen edhe sanksione sipas parashikimeve ligjore. Te gjitha këto shoqërohen me aktivitete që synojnë informimin dhe sensibilizimin e komunitetit, organeve të administratës publike dhe subjekteve private për të nxitur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke dhënë informacionin që i nevojitet atij.

Ligji i njeh KMD të drejtën për të ushtruar tre lloj kompetencash: A – kompetenca vendimarrëse; B – kompetenca rekomanduese dhe hulumtuese; dhe C –kompetenca për ndergjegjesimin kundër diskriminimit.

Kompetenca vendimarrëse

KMD ka prerogativën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar si dhe ankesat e organizatave të shoqërisë civile që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi.

Në këtë kuptim, KMD ka kompetencën të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit si dhe të vendosë sanksione administrative të parashikuara në Ligj. Në rast se një çështje diskriminimi bëhet objekt shqyrtimi gjyqësor, me miratimin e individit që është viktimë e diskriminimit, KMD mund të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore.

Kompetenca hulumtuese dhe rekomanduese

KMD është organi përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe i vetmi mekanizem për zbatimin efektiv të saksioneve ligjore për barazinë përpara ligjit. KMD ka të drejtë të kryejë sondazhe në lidhje me diskriminimin dhe në bazë të rezultateve përkatëse mund t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, dhe duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.

KMD nëpërmjet publikimit të raporteve periodike është organi përgjegjës për progresin në luftën kundër diskriminimit duke qënë në këtë mënyrë promotor i arritjes se barazisë reale dhe shanseve të barabarta për të gjithë individët.

Gjithashtu KMD luan rol të rëndësishëm në raportimet për diskriminimin para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë që kanë në mision të tyre mbrojtjen nga diskriminimi.

Kompetenca për ndergjegjesimin kundër diskriminimit

Kompetencat e KMD shtrihen edhe në nxitjen e aplikimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Roli i KMD është të sensibilizojë publikun mbi barazinë dhe mosdiskriminimin nëpërmjet informacioneve të shkruara, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara. KMD duhet të përcojë në publik informacione të qarta mbi të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat

joqeveritare; të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në kuptimin dhe aplikimin e dispozitave ligjore kundër diskriminimit.

Në fokus të kësaj Guide janë çështjet për diskriminimin gjinor në sektorin ekonomik dhe në këtë kontekst, rëndësi do t'i kushtohet mbrojtjes nga diskriminimi në këtë sektor.

Ligji nr.10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i kushton rëndësi e vecantë mbrojtjes nga diskriminimi në punë dhe barazia në shërbime dhe në të mira, që përfshihen në rrethin e te drejtave ekonomike.

Te drejtat që lidhen me punësimin

Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te KMD, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Është me rëndësi të theksohet se gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion, në çdo kohë, në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi.

Diskriminimi në punë, përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) shpalljen e vendeve të lira të punës;
- b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;
- c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;
- ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.

Cdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundërt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve përbën gjithashtu shkak për diskriminim dhe është objekt hetimi nga ana e KMD.

Ofrimi i te mirave dhe shërbimeve

Cdo personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

Te gjithë shtetasit duhet të kenë mundësi të barabarta për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku; mundësi për të marrë ose për të përfitur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; kontributin dhe mundësinë për të përfitur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun; mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor; sistemimin në një vend ku ofrohet strehim; shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera; shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim; lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim; lehtësi për transport ose udhëtim; shërbimet e profesioneve të lira.

Personat fizike ose juridike, që ofrojnë të mira dhe shërbime për publikun, ndalohen me ligj të mos pranojnë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitim të këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

Procedurat e shqyrtimit të ankesave nga KMD

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal. Organizata me interesa legjitime paraqet prokurë të posaçme për të përfaqësuar personin ose grupin e personave. Forma standarte e ankesës gjendet pranë zyrave të KMD (adresa: Rr: Sami Frashëri, nr.10, Kati II, Tiranë), si dhe në faqen e internetit: www.kmd.gov.al.

Ankesa nuk pranohet nëse:

- a) është anonime;
- b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat ligjore;
- c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një anekese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;
- ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;
- d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja e dëmtuarit, për këtë fakt.

Njoftimi i palëve

Personat fizikë ose juridikë, kundër të cilëve është paraqitur ankesa, njoftohen me shkrim nga komisioneri brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së ankesës.

Pagesa për shqyrtimin e ankesës nga KMD

Komisioneri nuk i ngarkon ankuesit me ndonjë tarifë për shqyrtimin e ankesës.

Shqyrtimi i ankesës nga KMD

Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet, duke i kërkuar për këtë qëllim ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër. Në rast se e vlerëson të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.

Gjithashtu, komisioneri, në rast se e vlerëson oportune, kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Vendimi i KMD

Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e

duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Sanksionet qe vendos KMD

Në rast se vërtetohet një rast diskriminimi, KMD vendos sanksione të cilat duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) masa të jetë e efektshme dhe parandaluese; dhe
- b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh:
 - i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe
 - ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve;
- c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e parashikuara në pikën (b) më sipër;

Sanksionet me gjobë

Çdo person që shkel dispozitat e Ligjit nr.10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dënohet me gjobë si më poshtë:

- a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë;
- b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

Vendimi për vënien e një mase ndëshkimore me gjobë cakton gjithashtu afatin e arsyeshëm, brenda të cilit paguhet gjoba.

Sanksione te tjera

Si mjet të fundit, veçanërisht kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit

të caktuar nga komisioneri, dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij.

E drejta e ankimit ne gjykatë kundër vendimit të KMD

Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Në referim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 11, datë 02.10.2009, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është i formës së prerë, në rast se objekt i kundërshtimit në gjykatë është akti administrativ që vendos gjobë ndaj paditësit. Si rrjedhojë, në rast se një vendim i KMD, me anë të të cilit një subjekt është dënuar me gjobë për shkak se ka kryer sjellje diskriminuese, kundërshtohet gjyqësisht, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor do të jetë i formës së prerë.

Në analizë të sa më sipër, rezulton se mekanizimi i krijuar me ligj për mbrojtjen nga diskriminimi është efektiv, për sa kohë shqyrtimi i ankesave të individëve, interesat e të cilëve janë çenuar nga sjellje diskriminuese, përfundon në një kohë relativisht të shkurtër.

v. **Indikatorët për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik**

Diskriminimi gjinor ne sektorin ekonomik/ Mundësi të barabarta për të drejtat ekonomike

Shanset e barabarta i duhen ofruar njësoj të gjithë individëve. Pavarësisht se parimi i barazisë gjen rregullim në ligje e akte nënligjore, gratë realisht përballen me pengesa dhe vështirësi në sektorin ekonomik, që konsistojnë në nivel të lartë të papunësisë, kushte të papërshtatshme pune, akses të limituar në kreditmarrje dhe shërbimet financiare, perspektivë të ulët për karrierë, pjesëmarrje të ulët në trajnime dhe akses të kufizuar në pronësi.

Në mënyrë që të kuptohet ndikimi i ndryshëm i varfërisë të gratë dhe burrat, është e domosdoshme të shikohet ndarja e pjesës më të madhe të tregut të punës mbi bazat gjinore. Shumë shpesh, edhe pse kontributet e grave janë të domosdoshme shoqërisht dhe ekonomikisht dhe do të duhej të vlerësoheshin shumë lart, gratë punojnë në mirëmbajtjen e shtëpive, duke plotësuar obligimet e tyre familjare për perkujdesjen ndaj fëmijëve, ndaj të sëmurëve dhe të moshuarve, si dhe duke bërë punët e tyre të përditshme dhe për këtë nuk marrin kurrfarë kompensimi material.

Një ndër dimensionet e varfërisë që prekin gratë është ndarja e tregut të punës duke u bazuar në gjini.

Deri sa varfëria prek familjen në tërësi, si rezultat i ndarjes së punës dhe përgjegjësi për mirëqenien familjare në baza gjinore, gratë duke tentuar që nën kushte të shtimit të mungesës të bëjnë menaxhimin e konsumit dhe prodhimit familjar; e mbajnë barrën e shpërpjestuar (Platforma e Pekinit për Veprim).

Varfëria gjithashtu krijohet përmes pagesës jo të barabartë për punë të njëjtë dhe mohimit ose kufizimit të arsimit ose të përfitimit të shërbime publike e sociale, si dhe mohimit ose kufizimit të të drejtave trashëgimore dhe pronësisë së tokës. Varfëria në dimensionin e saj politik, shfaq pabarazinë e të drejtave mes anëtarëve të shoqërisë tonë, gjë që u krijon atyre pengesë të madhe në qasje ndaj të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Varfëria gjithashtu zvogëlon qasjen ndaj informacioneve dhe ndaj mundësive për pjesëmarrje në organizata publike dhe procese vendimmarrese.

Arritja e barazisë gjinore në sektorin ekonomik krijon mundësinë për fuqizimin ekonomik të gruas duke bërë të mundur përmirësimin e kushteve të jetesës (duke rritur pavarësinë familjare dhe sociale të saj) si dhe rritjen e përfshirjes së saj në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Kështu zhvillimi i shoqërisë ecën

përpara pasi të gjithë individët, burra dhe gra, ndihen pjesëmarrës dhe kontribuojnë në mënyrë aktive në çdo pjesë të jetës. Arritja e barazisë gjinore është një element i rëndësishëm i drejtësisë sociale, pasi nëse popullsia e botës është 50% burra dhe 50% gra, të gjithë këta individë duhet të jenë pjesë e ofrimit dhe përfitimit të të mirave dhe shërbimeve.

Duke patur parasysh qëllimin e KMD, ky institucion mund të luajë një rol të rëndësishëm në adresimin e problemeve të sipërpërmendura, që janë të një rëndësie thelbësore për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e gruas sidomos në sektorin ekonomik.

Indikatorët për monitorimin dhe raportimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik

Për të gjetur mekanizmat e arritjes së barazisë gjinore në sektorin ekonomik, është e domosdoshme të përcaktohet qartë *status quo* e problemeve që pengojnë krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta. Për të bërë këtë përcaktim është e rëndësishme të identifikohen indikatorët e matjes së problemeve ekzistuese, indikatorë këta që do të lehtësojnë matjen e ecurisë së zgjidhjes së problemeve dhe mekanizmat efektivë për eliminimin e barrierave gjinore. Indikatorët janë pikërisht treguesit specifikë që paraqesin në sasi dhe në cilësi një problem të caktuar.

Indikatorët për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të marra përsipër nga ana e legjislatorit shqiptar, në kuadrin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, janë përgatitur në sajë të mbështetjes teknike dhe financiare të *United Nations Entity for Gender Equality and Empowerment of Women*, nga një grup ekspertësh dhe një grup pune ndërministor për Monitorimin e Barazisë Gjinore në Shqipëri nën drejtimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (“MPCSSHB”).

Këta indikatorë janë kategorizuar në tetë fusha:

Kuadri ligjor dhe Mekanizmat institucionalë

Pjesëmarrja në vendimarrje

Arsimi

Fuqizimi ekonomik, Punësimi

Mbrojtja Sociale

Shëndeti

Media

Dhuna në familje

Treguesit e monitorimit janë hartuar duke marrë për bazë detyrimet ligjore të shtetit ligjor në referim të Ligjit nr.9970, date 24.07.2008 “Për barazinë gjinore”, Ligjit nr. 9669, date 18.12.2006 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, Kodi i Punës në R.Shqipërisë, me ndryshime, Ligjit nr.

8876, date 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”, Kodi Zgjedhor në R.Shqipërisë, Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Luftën ndaj Dhunës në familje (2007 – 2013), Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (2007 – 2013), si dhe detyrimet e marra përsipër nga shteti shqiptar në bazë të akteve ndërkombëtare si CEDAW ratifikuar nga vendi ynë me Ligjin nr. 7776, datë 09.11.1993, Deklarata e Pekinit dhe Platforma e Veprimit, Deklarata e Mijëvjecarit e OKB, Rekomandimet e Këshillit të Europës për Standartet dhe Mekanizmat e Barazisë Gjinore

Në hartimin e indikatorëve të mësipërm janë marrë parasysh standartet kryesore dhe normat e zbatueshme nga Bashkimi European për arritjen e barazisë gjinore. Këta indikatorë janë miratuar ne baze te Urdhrit nr.1220, datë 27.05.2001 të Ministrisë të MPCSSHB. Për këtë guidë me interes të trajtohen janë indikatorët e miratuar në lidhje me fuqizimin ekonomik të gruas.

Indikatorët për fuqizimin ekonomik të gruas

Këta indikatorë gjenden në **Aneksin 1** bashkëngjitur kësaj Guide.

VI. Raste studimore te Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Rezulton se KMD ka trajtuar disa raste të sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, kryesisht qe i përkasin diskriminimit gjinor në punë.

Për periudhën Shtator 2011- Shtator 2012 KMD ka trajtuar dhe ka dhënë vendime për 17 raste të diskriminimit, prej te cilave 11 janë inicuar mbi bazën e ankesave të subjekteve që kanë pretenduar se janë viktima të sjelljeve diskriminuese, ndërsa 6 janë inicuar *kryesisht* nga KMD. Vetëm në 4 prej këtyre rasteve, pas përfundimit të hetimit administrativ, KMD arriti në konkluzionin se janë ezauruar sjellje dhe veprime diskriminuese.

KMD ka vendosur dënime me gjobë për dy subjekte, persona juridikë privatë që kanë kryer sjellje diskriminuese ndaj punëmarrëseve gra. Në një prej këtyre rasteve, gjoba është vendosur për shkak se subjekti i proceduar nuk ka zbatuar vendimin e KMD që sugjeronte rikthimin e ankuses, ndaj të cilës ishin kryer sjellje diskriminuese gjinore, në vendin e mëparshëm të punës.

KMD ka paraqitur mendimin me shkrim, në dy çështje gjyqësore me objekt denoncimin e sjelljeve diskriminuese dhe rivendosjen e të drejtave të shkelura, të inicuar nga subjekte që i janë drejtuar drejtepërsëdrejti Gjykatës me padi, pa ushtruar të drejtën e ankimit në KMD. Kjo mundësi për zgjedhjen e rivendosjes së të drejtës të cënuar nga sjelle diskriminuese, nëpërmjet ushtrimit të ankimit

në KMD apo drejtpërdrejt në Gjykatë, parashikohet shprehimisht në nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

KMD, duke u nisur nga informacionet në MEDIA për ankesat e disa grave që ishin strehuar në Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës Familjare, të cilat denonconin se ndaj tyre po ushtrohej dhunë psikologjike nga veprimet e Drejtueses së Qendrës, nisi hetimin në lidhje me këtë rast dhe arriti në përfundimin se ndaj grave dhe fëmijëve të strehuar në Qendër janë kryer sjellje diskriminuese nga ana e drejtueses së saj, shkelje këto që lidheshin me trajtimin e diferencuar të tyre për shkak të statusit social dhe shoqëror të këtyre individëve, (viktima të dhunës në familje).

Me vendimin nr. 9, datë 11.05.2012, KMD rekomandoi marrjen e masave të menjëhershme nga institucionet përkatëse për të mundësuar për gratë dhe fëmijët e qendrës, sigurinë e jetës dhe të shëndetit si dhe shkollimin e fëmijëve nga persona të specializuar. Në përgjigje të këtij vendimi, MPCSSHB me një shkresë zyrtare njoftoi KMD për masat që do të merreshin për të zgjidhur rastin në fjalë e për të ndaluar diskriminimin, njëra prej të cilave ishte zgjidhja e kontratës së punës me drejtuesen e Qendrës, në mënyrë të menjëhershme, për shkak të arsyeshem.

Ankesa të individëve në KMD mbi sjellje diskriminuese

I.

Ankuesi: I.K.
Subjekti kundër të cilit ankohet: Insitucion arsimor (Universitet)

Shkaku i diskriminimit që pretendohet:

Diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes arsimore dhe viktimizim për shkak të kritikave të bëra në institucionet shtetërore dhe në shtyp.

Statusi i procedimit: Në proces hetimi nga KMD

II.

Ankuesi: S.L.
Subjekti kundër të cilit ankohet: Operator biznesi privat (Hotel)

Shkaku i diskriminimit që pretendohet:

Diskriminim për shkak të aftësive të kufizuara

Statusi i procedimit: Në proces hetimi nga KMD

III.

Ankuesi: F.K.
Subjekti kundër të cilit ankohet: Institucion shtetëror (Drejtoria Rajonale Shëndetësore)

Shkaku i diskriminimit që pretendohet:

Gjendja arsimore si dhe viktimizim si rezultat i ankimeve dhe denoncimeve të ndërmarra prej saj.

Statusi i procedimit: Mbyllur më 30.07.2012, me vendiminn nr. 13, datë 30.07.2012 të KMD, ku rekomandohet kthimi i subjektit ankues në vendin e punës. Rekomandimi nuk është zbatuar brenda afateve ligjore dhe është vendosur sanksioni me gjobë.

IV.

Ankuesi:

S.Ç.

Subjekti kundër të cilit ankohet:

Operator biznesi privat

Shkaku i diskriminimit që pretendohet:

Denoncimi i sjelljeve diskriminuese ndaj saj

Statusi i procedimit: Mbyllur më 23.05.2012, me vendiminn nr.11 të KMD, ku rekomandohet mospërsëritja e sjelljeve diskriminuese. Rekomandimi nuk është zbatuar brenda afateve ligjore dhe është vendosur sanksioni me gjobë. Vendimi për sanksionin me gjobë është kundërshtuar në gjykatë dhe çështja është në proces gjykimi, ku KMD ka paraqitur mendimin e saj me shkrim.

VII. Praktika te mira për adresimin dhe monitorimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik

Duke iu referuar kompetencave që kuadri ligjor i ka ngarkuar KMD-së si dhe praktikës së vendeve të zhvilluara për adresimin dhe monitorimin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik, më poshtë paraqiten disa mjete dhe metodologji, si dhe të dhëna të dobishme, që mund të zbatohen dhe përdoren nga ana e KMD për të arritur ofrimin e shanseve të barabarta në sektorin ekonomik dhe eliminimin e barrierave gjinore.

Fushata ndërgjegjësuere

Kuadri ligjor kundër diskriminimit përbën një inovacion social në Shqipëri. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi rolin dhe kompetencat e KMD si dhe ofrimi i një informacioni të plotë dhe të qartë për çdo individ mbi diskriminimin dhe sjelljet diskriminuese, është një prej detyrave më të rëndësishme të KMD.

Të drejtat ekonomike të grave që parashikohen në aktet ndërkombëtare, legjislationin e brendshëm dhe aktet nënligjore, duhen të përcohen tek publiku nëpërmjet formave komunikuese të thjeshta dhe të kuptueshme nga cdokush.

Jemi mësuar që fushatat ndërgjegjësuere të jenë kryesisht mediatike ose shpërndarje materialësh informative. Shumëkush mendon se fushatat ndërgjegjësuere janë konsum kohe, energjish dhe humbje financiare.

Në fakt, fushatat ndërgjegjësuere janë të një rëndësie themelore pasi me anë të tyre publiku krijon përshtypje të qartë dhe familjarizohet me një fenomen të caktuar, si dhe percepton në një kohë të shkurtër të drejtat përkatëse dhe mënyrën për mbrojtjen e ketyrë të drejtave. Celësi i suksesit për të arritur rezultatet e mësipërme nëpërmjet një fushate ndërgjegjësuere është mënyra e realizimit të fushatës dhe kapacitetet e burimeve njerëzore për zbatimin e saj.

Për të patur rezultatet e pritshme në një fushatë ndërgjegjësuere duhet të gjenden përgjigjet e sakta të pyetjeve të mëposhtme:

1. Kush është qëllimi i fushatës?

Qëllimi i fushatës ka rëndësi thelbësore pasi në bazë të tij, ndërtohet një program i plotë për ndërgjegjësimin. Për të përcaktuar qëllimin e fushatës, duhet të hartohen qartë të drejtat dhe informacionet që do të përcohen nëpërmjet fushatës.

Për fushatën e ndërgjegjësimit të të drejtave të grave në sektorin ekonomik, duhet të hartohet një listë e plotë me të drejtat përkatëse. Në këtë listë nuk duhet vetëm të shkruhet e drejta, por të zërthehen komponentët e saj si dhe sanksionet në rast shkelje dhe mundësitë e denoncimit të shkeljes të së drejtës dhe rivendosjes së të drejtës së bashku me organet përgjegjëse ku denoncohet shkelja.

2. Cfarë rezultati konkret duhet të arrihet?

Pritshmëritë e fushatave janë që një grup sa më i madh individësh të ndërgjegjësohet për të drejtat dhe mënyrat e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave.

3. Cfarë mundësish organizative ka institucioni për organizimin e fushatës? Cfarë mungesash ka institucioni për organizimin e fushatës?

Kapacitetet organizative lidhen me mundësitë konkrete që ka institucioni të zbatojë një fushatë. Institucioni duhet të vlerësojë burimet njerëzore, në sasi, në ekspertizë, në aftësi organizative dhe mjete për të kuptuar se çfarë mund të realizojë më këto burime. Kjo analizë është e nevojshme, pasi evidenton mungesat e nevojshme në kuptim të burimeve njerëzore që zgjidhen duke kontraktuar ekspertizë jashtë institucionit, ose duke kërkuar ndihmën e organeve të specializuara.

Burimet financiare janë një element i domosdoshëm për realizimin e fushatës. Mungesa e tyre, duhet të jetë pikënisje për krijimin e bashkepunimeve me donatore, sponsor, media që mund të ndihmojnë si me mjete financiare, kontribute në natyre ose hapësira mediatike falas.

4. Kush janë partnerët e mundshëm në organizimin e fushatës?

Një fushatë ndërgjegjësuere do të ketë rezultate pozitive, nëse bashkëpunohet me partnerë dhe aktorët e duhur që kanë sensitivitet për çështjet që do të trajtojnë fushata. Për zhvillimin e fushatës ndërgjegjësuere kundër diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik, partnerë të rëndësishëm janë shoqëria civile, sindikatat, dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe institucionet arsimore në fushën e ekonomisë si dhe MEDIA.

Organizatat jo-fitimprurese janë një prej burimeve më të mëdha të një vendi për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve. Institucionet në zbatimin e një fushate ndërgjegjësuere duhet të marrin parasysh rolin e OJF-ve që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ku përfshihen të drejtat, mbrojtja e të cilave kërkohet të përcohet në publik.

Në Shqipëri, veprimtaria e organizatave jo fitimprurese organizohet dhe rregullohet nga Ligji nr. 8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jo fitimprurese” dhe Ligji nr.8789, date 07.05.2001“Per regjistrimin e organizatave jo fitimprurese”.

Organizatat jo fitimprurese quhen kështu pasi ato nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike ose ushtrojnë këtë lloj veprimtarie, por me kusht që të ardhurat e fituara prej saj të përdoren për realizimin e programit dhe qëllimeve të percaktuara në statutin e organizates. Organizatat jofitimprurese ndahen në shoqata, qendra dhe fondacione. Shoqata përbën organizate me anëtarësi dhe krijohet nga vullneti i lire i personave fizikë dhe juridikë dhe organi më i lartë i saj është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve. Qendra dhe fondacioni janë organizata pa anëtarësi dhe organi më i lartë i tyre përbëhet prej personave fizike që zgjidhen sipas kushteve të parashikuara në statut.

Parimet që udhëheqin organizatat jofitimprurëse janë:

1. Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut
2. Parimi i pavarësisë nga shteti

Organizata jofitimprurese gëzon personalitet juridik që nga dita që vendimi për regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë. Akti i themelimit dhe statuti përbejnë kontraten e anetareve për të krijuar organizatën jofitimprurese.

Një listë të plotë me kontaktet e organizatave të shoqërisë civile është bashkëngjitur si Aneksi 2.

Shoqëria Civile, si koncept nenkupton bashkimin e formave shoqerore qeveritare dhe jo qeveritare që synon përfshirjen e plote të shtetasve në zhvillimet politike, sociale dhe ekonomike dhe ndikimin në politikën shtetërore për të mbrojtur interesat e komunitetit dhe për të cuar me tej progreset demokratike.

Shoqëria civile siguron një monitorim të politikave shtetërore dhe ekspertizë në përmirësimin e këtyre politikave. Shoqëria civile përfshin veprimtaritë në fushën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, arsim, shkencë dhe kulturë, reformave ligjore e ekonomike, mbrojtjes së target grupeve të caktuara shoqerore si fëmijet, të rinjtë, gratë, të papunët, viktimat e krimeve, shtresat e marginalizuara etj.

Shoqëria civile është një element i rëndësishëm i së drejtës së organizimit dhe lirisë së mbledhjes. Veprimtaria e saj ndikon ndjeshëm në pjesëmarrjen e shtetasve në jetën politike, sociale, ekonomike, kulturore të një vendi duke ushtruar kështu me efikasitet të lartë të drejtën që po trajtojmë.

Ndikimet pozitive të OJF-ve në shoqëri

OJF-të janë një element i rëndësishëm i progresit shoqëror. Veprimtaria e tyre ndikon politikën shtetërore në fushën sociale, ekonomike, politike, kulturore etj duke krijuar politika të reja, ndryshuar apo duke përmirësuar ato ekzistuese. Organizatat e grave kanë ndikuar në hartimin dhe miratimin e legjislativioneve në mbrojtje të gruas.

Njëkohësisht OJF-të me anë të programeve trajnuese dhe edukuese janë bërë promotore të koncepteve, njohurive dhe praktikave të zhvilluara të vendeve të ndryshme të botës, duke i mbartur dhe sjelle prej këtyre vendeve në vendin tonë. Kështu OJF-të janë kthyer në burim ekspertizë për çështje të caktuara.

Sindikatat

Sindikatat rregullohen nga legjislativi shqiptar me Ligjin nr.7516, datë 07.10.1991, ndryshuar, si dhe në K.Punës (nenet 10, 139).

Cfarë janë sindikatat?

Sindikatat janë organizata shoqërore të pavarura që krijohen si bashkime vullnetare të punonjësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe e interesave ekonomike, profesionale e sociale të anëtarëve të tyre.

Sindikatat janë organizata shoqërore të pavarura nga punëdhënësi, administrata shtetërore dhe partitë politike, dhe nuk merren me veprimtari politike.

Sindikatat, me veprimtarinë që kryejnë, mbrojnë të drejtat dhe interesat e anëtarëve të tyre që lidhen me pagat, kushtet e punës, të banimit e të pushimit, si dhe nevojat social-kulturore, duke përdorur vetëm metoda e mjete demokratike të njohura me ligj, sic janë mbledhje, mitingjet, manifestimet dhe grevat. Sindikatat kanë të drejtë të mbrojnë edhe interesat ekonomike të punonjësve që kanë dalë në pension, ose që jetojnë me përkrahje sociale.

Statusi i sindikatave dhe organizimi

Sindikatat janë persona juridike. Ato kanë pasuri dhe ushtrojnë aktivitet ekonomik për kryerjen e veprimtarisë së tyre në përshtatje me qëllim për të cilin janë krijuar. Sindikatat mund të organizohen sipas degëve, profesionit ose mbi bazë territori në sektorin shtetëror ose privat.

Anëtarësia

Në sindikata kanë të drejtë të hyjnë të gjithë punonjësit, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, ideologjike e fetare. Të drejtën për të hyrë në sindikata e kanë edhe personat që kanë dalë në pension, ose që jetojnë me përkrahje sociale. E drejta për tu bërë anëtar i sindikatës përcaktohet në statutin e sindikatës.

Kontrata kolektive

Kontrata kolektive e punës që lidhet ndërmjet organeve drejtuese të sindikatës dhe punëdhënësit është detyrueshme. Mënyra e lidhjes së kontratës kolektive të punës, të drejtat dhe detyrat e paleve si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes tyre përcaktohen me ligj.

Kontrata kolektive e punës nuk mund t'i cenojë të drejtat dhe garancitë që punonjësve u njihen nga legjislacioni i punës dhe ai civil.

Të drejtat e sindikatës

Organet drejtuese të sindikatave kanë të drejta të mbajnë lidhje e të zhvillojnë bisedime me organet shtetërore dhe ekonomike, të cilat nga ana e tyre e kanë të detyrueshme tu vënë në dispozicion pa pagesë të dhënat e statistikës ekonomike e financiare.

Përfaqësuesit e organeve qendrore të sindikatave kanë të drejta të hyjnë në bisedime me Këshillin e Ministrave dhe me ministrin e institucionet e tjera

qëndrore për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, pagat, kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve, ose me pensionet dhe përkrahjen sociale.

Sindikatat kanë të drejtë të mbajnë lidhje e të bashkëpunojnë me organizatat dhe lëvizjet sindikaliste të vendeve të tjera dhe të bëhen anetare të organizatave dhe lëvizjeve sindikaliste ndërkombetare.

Sindikatat me kërkesën e punonjësve kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës dhe të përfaqësojnë në gjyq interesat e tyre, kur nëpërmjet punonjësve dhe punëdhënësve lindin konflikte në lidhje me marrëdhëniet e punës. Sindikata kanë të drejtë të mbrojnë edhe interesat ekonomike të punonjësve që kanë dalë në pension, ose që jetojnë në përkrahje sociale.

Procedura e krijimit dhe regjistrimi

Sindikatat krijohen me kërkesën e 300 punonjësve dhe regjistrohen në gjykatën e rrethit për sindikatat që funksionojnë në bazë rrethi. Kur sindikata e shtrin veprimtarinë e vet në disa rrethe, regjistrimi bëhet në gjykatën e rrethit ku sindikata ka selinë e saj. Për sindikatat që funksionojnë në bazë republike dhe për ato që funksionojnë në bazë dege, regjistrimi bëhet në gjykatën e rrethit të Tiranës.

Marrëdhëniet me institucione të tjera

Vetëm përfaqësuesit e organeve qendrore të sindikatave që funksionojnë në shkallë vendi, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me Presidentin dhe Këshillin e Ministrave për problemet që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale. Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave që funksionojnë në bazë dege, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me ministritë dhe organet e tjera qendrore për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale. Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave që funksionojnë në bazë territori, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me përfaqësuesit e organeve drejtuese të pushtetit lokal dhe përfaqësuesit e punëdhënësit në atë territor për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale. Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave në qendra pune kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me përfaqësuesit e punëdhënësit në këto qendra pune për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale.

Një listë e plotë e Sindikatave të regjistruara në Shqipëri është bashkëngjitur si Aneksi 4.

DEKLARATAT MË TË RËNDËSISHME TË NORMAVE THEMELORE TË PUNËS NGA ILO

Konventa nr. 87 e ILO-s: Liria sindikale dhe mbrojtja e së drejtës sindikale *(miratuar në vitin 1948)*

- Punëmarrësi dhe punëdhënësi mund të krijojnë organizata për mbrojtjen e tyre (sindikata, komitete përfaqësuese) dhe të bëhen anëtarë në këto organizata.
- Këto shoqata nuk mund të shkrihen ose të pezullohen nga autoritetet administrative.

Konventa nr.98 e ILO-s: E drejta e organizimit dhe e drejta e marrëveshjeve kolektive *(miratuar në vitin 1949)*

- Punonjësit duhet të përfitojnë një mbrojtje nga paragjykimet, të cilat lindin, për shembull, sepse ata janë anëtarë të një sindikate (p.sh. shkarkimi nga puna për shkak të anëtarësisë në një sindikatë ose vendosja e kushtit që ata duhet të largohen nga sindikata, përpara se ata të mund të fillojnë punë në një vend pune).
- Duhet të nxiten dhe të promovohen zhvillimet e bisedimeve vullnetare ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të punëmarrësve, të cilat kanë për qëllim arritjen e kontratave të përbashkëta të punës (kontratave kolektive) për rregullimin e kushteve të punës dhe të pagës.

Konventa nr.29 e ILO-s për punën e detyrueshme *(miratuar në vitin 1930)* **dhe Konventa nr.105 e ILO-s për ndalimin e punës së detyrueshme** *(miratuar në vitin 1959):*

- Çdo formë e punës së detyruar është e ndaluar (këtu bëjnë përjashtim masat shtetërore, si shërbimi ushtarak etj.).
- Këtu përfshihet edhe mjeti i dhunës politike ose i arsimit politik, por ndalohet gjithashtu edhe ndëshkimi fizik i punëtorëve, mbajtja e dokumenteve ose e pagës, me qëllim që të ushtrohet presion mbi punëtorët (skllavëria për pagën).

Konventa nr.100 e ILO-s për shpërblimin e barabartë *(miratuar në vitin 1951):*

- Gjatë përcaktimit të pagës nuk ka asnjë ndryshim në pagë për shkak të gjinisë. Të gjithë punonjësit që kryejnë të njëjtën punë, kanë të njëjtat përfitime sociale, të njëjtat kushte pune dhe të njëjtat mundësi për kualifikimin e mëtejshëm profesional.

Konventa nr.111 e ILO-s për diskriminimin në punë dhe profesion *(miratuar në vitin 1958):*

- Të gjithë qeniet njerëzore, pavarësisht racës, gjinisë dhe besimit të tyre, kanë të njëjtat të drejta që të ndjekin mirëqenien e tyre materiale dhe zhvillimin shpirtëror në kushtet e lirisë dhe të dinjitetit, të sigurisë ekonomike dhe me të njëjtat kushte të favorshme.
- Për këtë arsye nuk do të ushtrohet asnjë diskriminim (diferencim, përjashtim ose preferencë) i bërë mbi bazën e racës, kombësisë, besimit fetar, aftësisë së kufizuar, gjinisë, orientimit seksual, amësisë, moshës dhe të bindjeve politike, dhe as mbi bazën e anëtarësimit në parti politike ose në sindikata. Punonjësit nuk do t'u nënshtrohen as testeve të HIV SIDA-s, dhe as testeve të shtatzënisë.

Konventa nr.138 e ILO-s për moshën minimale të marrjes në punë (miratuar në vitin 1973) dhe Konventa nr. 182 për ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve (miratuar në vitin 1999):

- Në përputhje me përcaktimet ligjore kombëtare nuk duhet të merret në punë asnjë fëmijë (si rregull, periudha e përfundimit të arsimit të detyrueshëm përfundon me arritjen e moshës 15 vjeç ose në disa lande me arritjen e moshës 14 vjeç). Punëmarrësit e rinj (si rregull janë ata persona që kanë mbushur moshën 18 vjeç) nuk duhet të caktohen në vende pune, të cilat rrezikojnë jetën, shëndetin ose moralin e tyre.

Konventa nr.99 e ILO-s për përcaktimin e pagave minimale në sektorin e bujqësisë (miratuar në vitin 1951):

- Do të merren masa në nivel kombëtar për përcaktimin e pagave minimale në sektorin e bujqësisë. Nëpërmjet rregullimeve ligjore ose të kontratave kolektive është e mundur që këto paga minimale të kompensohen pjesërisht nëpërmjet kontributit në natyrë. Kompensimi duhet t'i shërbejë përdorimit personal të punëmarrësit dhe familjeve të tyre, si dhe të përputhet me nevojat e tyre.
- Pagat minimale të përcaktuara kanë fuqi ligjore për punëdhënësin dhe punëmarrësin e përfshirë dhe nuk lejohen pagat nën këto kufij.

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë që rregullohen me Ligjin nr.9640, datë 9.11.2006 “*Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise*”, janë persona juridikë, që nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse. Ato zhvillojnë funksione të perfaqesimit dhe të mbrojtjes së interesave të ligjshëm ekonomikë të anëtarëve të tyre.

Ne misionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë përfshihen:

- Bashkëpunimi i biznesit me qeverinë vendore dhe qendrore
- Mbëhtetja për sipërmarrjet e reja
- Përfshirja e antarëve në rrjetin biznesor ndërkombëtar

Ndër kompetencat e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë janë:

- Mbajtja e Regjistrit të antarësisë së bizneseve
- Organizimi dhe pjesëmarrja në panairë dhe ekspozita me karakter vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Organizimi i konsultave për harmonizimin e marrëdhënieve midis antarëve të saj si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare dhe civile, nëpërmjet rrugës së ndërmjetësimit dhe arbitrazhit.
- Organizimi i takimeve me grupe të interesit për propozime dhe vlerësime të lidhura me nismat ligjore apo politikë publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e antarëve të saj.

Gjithashtu, në Shqipëri janë organizuar dhe funksionojnë në formën e organizatave jo fitimprurëse me anetarësi edhe dhoma tregtie që përfaqësojnë bizneset e huaja që zhvillojnë aktivitet tregtar në vend.

Një listë e plotë me kontaktet e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në vend dhe dhomat e bizneseve të huaja është bashkëngjitur si Aneksi 3.

Institucionet arsimore

Në vendet e zhvilluara bashkëpunimi i institucioneve për barazinë gjinore me institutet arsimore është shumë i përhapur për dy arsye:

1. Edukimi i brezit të ri dhe krijimi i koncepteve bazë
2. Krijimi i një grupi kuadrosh të rinj me njohuri të plota mbi çështje të caktuara

Një listë e plotë me kontaktet e institucioneve arsimore në Shqipëri është bashkëngjitur si Aneksi 6.

Bashkëpunimi me universitetet dhe vecanerisht fakultetet e ekonomisë dhe financës është mëse i domosdoshëm për të mundësuar në të ardhmen eliminimin e barrierave gjinore në sektorin ekonomik.

Njësitë e pushtetit vendor

Pushteti vendor është njësi e qeverisjes më pranë qytetarit. Bashkëpunimi me këto njësi administrative është i vlefshëm pasi rrit efikasitetin e fushatës ndërgjegjësuese duke mundësuar përcimin e mesazheve të saj në komunitetin e gjerë.

Njësitë e pushtetit vendor kanë gjithashtu kompetenca për barazinë gjinore dhe në të njëjtën kohë struktura përkatëse për realizimin e këtyre tagrave, të cilat mund të shërbejnë si një mbështetje e fuqishme me burime njerëzore dhe kontribute në natyrë për realizimin e fushatave ndërgjegjësuese.

Një listë e plotë e njësive të pushtetit vendor në Shqipëri është bashkëngjitur si Aneksi 5.

Media

Media dhe shtypi i shkruar duhen siguruar si partnerë të përhershëm në cdo nismë kundër diskriminimit. Prania e përditshme e shtypit të shkruar dhe informacioneve mediatike në jetën e cdo qytetari bën të mundur percjelljen me lehtësi dhe shpejtësi të mesazheve ndërgjegjësuere tek publiku i gjerë.

Media dhe shtypi i shkruar mund të bëhen lehtësisht partnerë në rast se në fushata ndërgjegjësuere është interaktive, sjell risi që lë përshtypje në mendjen e individit, përben lajm që u intereson një game të gjërë njerëzish, tërheq vëmendjen e individëve nga elementë të pazakonshëm që ndodhin, si psh. një seminar për të drejtat e grave në sektorin ekonomik nuk është më atraktiv për mediat se sa një ekspozitë pikturë ose teatër që trajton artistikisht këto çështje.

Një listë e plotë me kontaktet e mediave në Shqipëri është bashkëngjitur si Aneksi 7.

5. Kush është grupi i synuar i fushatës (target grupi)?

Në fushatat ndërgjegjësuere për luftën kundër diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik, grupi i synuar në mënyrë direkte janë gratë me potenciale zhvillimi ekonomik, gratë e punësuar, gratë që janë diskriminuar nga politikat e shkurtimeve të vendit të punës, gratë që mund të marrin pjesë në programe trajnimit të vazhdueshëm profesional, gratë që mund të kenë akses në kredi, në pronësi, në shërbime ekonomike, gratë në nevojë me kushte të vecanta jetese, si gratë kryefamiljare, ato me familjarë me aftësi fizike të kufizuar, nënat me shume fëmijë, gratë në zonat rurale, etj.

Por në të njëjtën kohë nga fushata ndërgjegjësuere afektohen dhe kuptojnë mesazhe edhe operatorët e biznesit, akademikët, sindikatat, organizatat e shoqërisë civile, etj. të cilët në të njëjtën kohë ndërgjësohen për detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktor kundër diskriminimit dhe sanksionet me të cilat përballen shkelësit e dispozitave ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në bazë të përzgjedhjes së grupit të synuar të fushatës bëhet edhe përcaktimi i partnerëve bashkepunues në të, psh. nëse do të përcohen mesazhe për të drejtat e gruas në vendin e punës, partnerë duhet të jenë medoemos organizatat e biznesit dhe operatorët ekonomike (punëdhënësit), si dhe sindikatat.

6. Cfarë taktikash do të përdorën në fushatë?

Në përcaktimin e taktikave të fushatave duhet të mbahet parasysh që mesazhet e saj duhet të jenë të kuptueshme dhe të qarta për çdo individ.

Për këtë taktikat e fushatës duhet:

- Të jenë interaktive dhe të tërheqin vëmendjen e qytetarëve;
- Të sjellin risi që lë përshtypje në mendjen e qytetarit;
- Të përmbajnë mesazhë të shkurta dhe kuptimplota;
- Të përmbajnë figura që nuk krijojnë disinformim;

Disa taktika mund të jenë:

- Spote televizive;
- Një grup grash që shkojnë derë më derë dhe përcojnë mesazhe të shkruara shkurt;
- Teatër rrugë ku demaskohen sjelle diskriminuese që shfaqen në njësi vendore dhe zona rurale, fabrika, uzina, kopshte, cerdhe. Shfaqet pasohen me diskutime mbi të drejtat që promovohen;
- Shfaqje e dokumentarëve në Media me mbulim të gjerë territorial në orë me shikim më të lartë;
- Demonstrime masive me elementë interaktivë, si psh shembja e një muri kartoni ngritur në mes të një rrugë me frekuentim të gjerë publik, ku në karton është shkruar *“Une jam kunder diskriminimit gjinor dhe pranoj ta shëmb murin e barrierave gjinore”*;
- Filma dhe dokumentarë që përcojnë mesazhe;

Filma dhe dokumentarë që përcojnë mesazhe

Filmat dhe dokumentaret “Pasaportës së Dinjitetit” dhe seriali “Gratë mbajnë Qiellin”, “Lëvizja Popullore për Arsimim në të Drejtat e Njeriut (PDHRE)” kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për avancimin e të drejtave të grave. “Pasaporta e Dinjitetit” përmes shqyrtimit global të 12 fushave kryesore të shqetësimit nga “Platforma e Pekinit për Veprim” dhe duke u bazuar në raporte të ekspertëve, si dhe në informata të dorës së parë nga gratë, krijon një raport mes obligimeve ligjore dhe realitet në shumë shtete. Me përkrahjen e Institutit të Vjenës për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Departamentit për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austrisë, në vitin 1999 me rastin e festimit të 20 vjetorit të CEDAW-it, është botuar manual tjetër “Në mesin e tregimeve të tyre dhe realitetit tonë”, si pjesë integrale e serialit të lartpërmendur, “Gratë mbajnë qiellin”. Me këtë kontribut të çmuar, Lëvizja Popullore për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut, ofroi material të çmueshëm për trajnimin e brezave të ardhshëm të aktivistëve për të drejtat e grave.

Sondazhe pjesorë dhe të përgjithshëm; Rekomandimet; Takimet

Sondazhet nuk janë gjë tjetër vecse pyetesorë me disa pyetje të mirëstruktura të cilave duhet t'u përgjigjen pjesëtarët e grupeve të synuara.

Sondazhet shërbejnë për të kuptuar nivelin e problematikave në një fushë të caktuar në komunitet, me qëllim identifikimin e nevojave dhe përmirësimin e status quo-së me ndërhyrje qoftë legjislative ashtu dhe plane konkrete veprimi.

Sondazhet janë të pjesshme nëse kryehen për një territor të caktuar dhe të përgjithshëm nëse kryehen për gjithë territorin ku vepron një institucion.

KMD në zbatim të kompetencave të saj mund të realizojë sondazhe në qendrat e punës, në institucione arsimore, në njësi vendore të caktuara, etj.

Pyetsorët për sondazhet përgatiten me ndihmën e ekspertëve të fushës ku përfshihen çështjet që do të trajtojnë sondazhi.

Në rastin e diskriminimit gjinor në sektorin ekonomik, pyetesorët duhen hartuar me asistencën e ekspertëve juristë dhe ekonomistë. Në hartimin e pyetesorëve merren për bazë të drejtat e sanksionuara nga legjislacioni në fuqi dhe mekanizmat e zbatueshme, si psh. indikatorët e harmonizuar për monitorimin e diskriminimit gjinor që përshkruhen hollësisht në Kapitullin III të kësaj Guide.

Rezultatet e pyetesorëve mblidhen dhe analizohen nga ekspertët, të cilët japin edhe komentet mbi problematikën e hasura dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e situatës.

Këto raportë përbëjnë një bazë të mirë burimore për institucionet, që të ndërmarrin iniciativa për përmirësimin e legjislacionit, politikave, planeve të veprimit, mekanizmave mbrojtjes në garantimin e të drejtave që kanë qënë në fokus të sondazheve.

Nëpërmjet përfundimeve të sondazheve, KMD mund të iniciojë procese të rëndësishme në mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik, duke propozuar masa konkrete për zgjidhjen e problemeve të konstatuara.

Në hartimin e rekomandimeve dhe iniciimit të proceseve për amendim ligjesh apo politikash, është e rëndësishme që KMD të kryejë takime periodike me grupe interesi për t'i dhënë veprimeve të saj karakter gjithëpërfshirës dhe me qëllim që interesat e sa më shumë grupeve të përfshihen në mbrojtjen nga diskriminimi. Këta grupe interesi duhen lejuar të shprehin mendimet e tyre mbi dokumentat e

hartuara prej KMD, dhe kjo e fundit duhet të marrë parasysh për aq sa është e mundur sugjerimet e tyre. Për të kuptuar grupet e interesit lexo Kapitullin VII, pika 4 të kësaj Guide.

Trajnimet

Këto aktivitete kanë për qëllim të përmirësojnë të kuptuarit e të drejtave dhe mekanizmat e mbrojtjes së tyre.

KMD mund të realizojë trajnime për organizatat e punëdhënësve, sindikatat, gratë e punësuar, gratë e papuna, operatorët bankarë, shoqërinë civile, studentët, nëpunësit e njësisve vendore etj, për të rritur njohuritë e tyre mbi barazinë gjinore, të drejtat ekonomike të grave, pasojat e shkeljes së këtyre të drejtave, detyrat e organeve që garantojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Një hap i rëndësishëm në drejtim të implementimit të plotë të instrumenteve për të drejta të grave është edhe trajnimi i grave avokate për përdorimin e mekanizmave për të drejtat e njeriut. Për momentin, shumë pak gra kanë njohuri për instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndërsa edhe më pak i dijnë mënyrat e drejta për përdorimin e atyre instrumenteve.

Qëllimet e Trajnimeve

- Ngritja e vetëdijes për të drejtat e grave;
- Familjarizimi me terminologjinë juridike për të drejtat;
- Shqyrtimi i qëndrimeve të ndryshme për të drejtat e grave;
- Diskutimi për instrumentet ligjore që trajtojnë të drejtat e grave;

Grupi i synuar:

Gratë dhe burrat

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror:

20 – 25 njerëz

Kohëzgjatja:

afërsisht 60 minuta.

Materiale:

Kopje të akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas, letër dhe lapsa.

Përshkrimi i aktivitetit/ Instruksione

Pas zhvillimit të një prezantimi hyrës për aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas moderatori duhet t'i kërkojë pjesëmarrësve që të ndahen në 4-5 grupe. Secilit grup i caktohet një pjesë e caktuar e legjislacionit për ta diskutuar dhe përmbledhur në një fletë A2.

Secili grup prezanton rezultatin e tij në një kohë prej 15 minutash.

Puna në grupe prej 4-5 personash, mundëson diskutim më intensiv, kurse pjesëmarrësve të qetë dhe të pasigurt u jep rast më të madh për t'u përfshirë. Sidoqoftë, rezultatet e punës së grupit gjithmonë duhet të prezantohen dhe diskutohen pranë të gjithëve, në mënyrë që të sigurohet niveli i njëjtë i njohurisë për të gjithë pjesëmarrësit.

Pyetje që shtrohen pas prezantimeve të grupeve

- A përcaktohen të drejtat e grave ndaras prej të drejtave të njeriut në shoqëri?
- A ekzistojnë të drejta të caktuara që burrat i gëzojnë pa problem, kurse gratë duhet të bëjnë përpjekje të veçanta për t'iu njohur të drejtat e njëjta?
- A ekzistojnë fusha të jetës ku gratë duhet të veprojnë përmes ndërmjetësimit të burrave? Cilat janë pengesat e autonomisë së grave?
- Çfarë parashikon kushtetuta për të drejtat e grave? A ka mospërputhje mes realitetit jetësor dhe parimeve të kushtetutës?
- A dini për ndonjë rast konkret që është duke u zhvilluar në gjyq lidhur me të drejtat e grave? Për çka bëhet fjalë? Cilat të drejta janë shkelur?

Në varësi të interesit të pjesëmarrësve dhe temës së kursit, ky aktivitet mund të zhvillohet me çfarëdo lloj dokumenti ligjor. Pra, të drejtat ekonomike të grave mund të diskutohen me lehtësi në këto lloj trajnimesh.

VIII. Bibliografia

United Nations 2001 *Multilateral Treaty Framework: An Invitation to Universal Participation, Focus 2001: Rights of Women and Children.*

United Nations 2000 *Women, Peace and Security*, Study submitted by the Secretary- General pursuant to Security Council resolution 1325 (2000).

International Council of Women: <http://www.icw-cif.org>

Terre des Femmes – Menschenrechte für die Frau e.V.:
<http://www.terresdesfemese.de>

Organization of American States: <http://www.oas.org>

People’s Movement for Human Rights Education: <http://www.pdhre.org>

RSMLAC – Latin American Women’s Health Network: <http://rsmlac.org>

United Nations: Commission on the Status of Women:
<http://www.undp.org/fwcw/csw>

United Nations: Committee on the Elimination of Discrimination against Women: <http://www.un.org/DPCSD/daw/CEDAW>

United Nations: Division for the Advancement of Women

Për referencë janë marrë gjithashtu të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë që janë përmendur në këtë Guidë.

ANEKS 1 - Indikatorët për monitorimin dhe raportimin e fuqizimit ekonomik të grave

Fusha 3 – Fuqizimi ekonomik i grave dhe mundësitë e tyre për punësim dhe trajnime të mëtejshme

Treguesit kryesor të fushës nr. 3					
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Miraturar nga MPÇSSHB Udhëzim i ministrisë nr. 1220 dt 27 Maj 2010
1. Përqindja e femrave dhe meshkujve të punësuar në tregun formal të punës, të ndara sipas moshës, nivelin arsimor dhe vendbanimit (prefektura).	%	INSTAT	SHKP-MPÇSSHB	Vjetore, tremujore pas tremujorit të dytë të vitit 2011	√
2. Përqindja e grave / meshkujve me aftësi të kufizuara të punësuar në tregun formal të punës, të ndara sipas moshës, nivelin arsimor	%	NA	NA	INSTAT-LFS	
3. Shkalla e papunësisë në nivel kombëtar sipas gjinisë	%	INSTAT/LFS	INSTAT të mbledhura nga MPÇSSHB	Vjetore, tremujore pas tremujorit të dytë të vitit 2011 nga LFS	√
4. Përqindja e femrave dhe meshkujve të larguar nga puna, të ndara sipas gjinisë, prefekturë, dhe llojin e aktivitetit ekonomik	%	INSTAT-LFS		Vjetore	√
5. Përqindja e femrave / meshkujve që përfitojnë benefite nga papunësia	%	INSTAT		Vjetore dhe tremujore	√

6. Përqindja e femrave / meshkujve kryefamiljarëve që marrin ndihmë sociale në të holla (Ndhma Ekonomike)	%	MPÇSSHB mbledhur nga SSHS	INSTAT-LSMS	Vjetore (dhe sa here mblidhet LSMS)	√
7. Numri i femrave / meshkujve marrin pensione sipas vendbanimit (urban / rural)	numri	INSTAT të mbledhura nga ISSH		vjetore	√
8. Përqindja e femrave nga grupet e veçanta - duke përfshirë gra kryefamiljare - që përfitojnë nga programet e punësimit, duke përfshirë punë me kohë të pjesshme dhe punë për komunitetin	%	MPÇSSHB		Vjetore	
9. Përqindja e grave që zotërojnë biznese të vogla / të mesme / të mëdha	%	INSTAT-SSE		Vjetore	√
10. Përqindja e grave të trajnuar në DRPTP dhe të atyre që marrin trajnim profesional pa pagesë dhe me tarifa të reduktuara	%	MPÇSSHB		Vjetore	√
11. Përqindja e grave me aftësi të kufizuara të trajnuara në DRPTP dhe të atyre që marrin trajnim profesional pa pagesë dhe me tarifa të reduktuara	%	MPÇSSHB		Vjetore	
12. Përqindja e femrave të punësuarra nëpërmjet trajnimit profesional	%	MPÇSSHB		Vjetore	√
13. Përqindja e	%	INSTAT-LFS		Vjetore	√

femrave dhe meshkujve të cilët janë të punësuar jozyrtarisht (mosha 15 e lart), sipas vendbanimit dhe moshës					
14. Përqindja e femrave dhe meshkujve që përfitojnë trajtim ngë kujdesi shëndetësor	%	ISKSH		Vjetore	√

Treguesit kryesorë të fushës nr. 3 sugjeruar që të mblidhen në të ardhmen				
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave
1. Numri i institucioneve publike dhe bizneseve private që ofrojnë premisa punësimi të cilat janë të arritshme nga gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara	numri	MPÇSSHB		vjetore

Fusha 4 – Promovimi i të drejtave të grave dhe vajzave për arsimim cilësor

Treguesit kryesorë të fushës nr.4					
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Miratur nga MPÇSSHB Udhëzim i ministrisë nr. 1220 dt 27 Maj 2010
1. Përqindja e braktisjes femra/meshkuj në nivelin fillor/i detyrueshëm (5-16 vjeç)	%	MPÇSSHB mbledhur nga MASH		Vjetore	√
2. Përqindja e braktisjes femra/meshkuj me aftësi të kufizuara në nivelin fillor / i detyrueshëm (5-16 vjeç)	%	MPÇSSHB mbledhur nga MASH		Vjetore	√

3. Raporti bruto i regjistrimit për arsimin fillor për vajzat / djemtë	%	INSTAT	INSTAT-LSMS	Vjetorë (dha sa herë zhvillohet LSMS)	√
4. Vitet e shkollimit të përfunduar, sipas nivelit dhe gjinisë, si dhe të ndara në zona rurale dhe urbane	numër	INSTAT-LSMS		sa herë zhvillohet LSMS	√
5. Raporti femër / mashkull midis krerëve të institucioneve arsimore nga niveli (fillor, të mesëm dhe universitar) dhe shefat e departamenteve Rajonale Arsimore	%	MPÇSSHB mbledhur nga MASH		Vjetore	√
6. Raporti femër / mashkull në regjistrimet në arsimin e nivelit fillor dhe të mesëm	%	INSTAT	INSTAT-LSMS	Vjetorë (dha sa herë zhvillohet LSMS)	√
7. Raporti femër / mashkull me aftësi të kufizuara në regjistrimet në arsimin e nivelit fillor dhe të mesëm	%	MASH		Vjetore	√
8. Raporti i femrave dhe meshkujve që kanë marrë diploma në degë të ndryshme në universitetet publike	%	INSTAT		Vjetore	√
9. Numri i të rinjve me aftësi të kufizuara (meshkuj / femra) të regjistruar në shkolla të specializuara	numër	MPÇSSHB		Vjetore	√
10. Raporti i femrave dhe meshkujve që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e mesëm dhe të lartë sipas fushave të profilit të specializimit	%	INSTAT		Vjetore	√
11. Raporti i femrave dhe meshkujve me aftësi	%	MPÇSSHB mbledhur nga MASH		Vjetore	√

të kufizuara që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e mesëm dhe të lartë sipas fushave të profilit të specializimit					
---	--	--	--	--	--

Treguesit kryesorë të fushës nr. 4 sugjeruar që të mblidhen në të ardhmen					
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave
1. Numri i mësuesve, të cilët marrin kurse edukuese fillestare dhe në vazhdim mbi: a) ndërgjegjësimin gjinor; b) edukimin mbi shëndetin riprodhues dhe edukata seksuale, sipas gjinisë, vendbanimit dhe lënda që japin	numri	IZHA			Vjetore
2. Numri i teksteve në nivel fillor dhe të mesëm shqyrtuar përmes lenteve gjinore	numri	IZHA			Vjetore

Fusha 5 – Përmirësimi i qasjes së grave dhe vajzave në rrisht në shërbimet sociale cilësore

Treguesit kryesorë të fushës nr.4					
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Miratur nga MPÇSSHB Udhëzim i ministrisë nr. 1220 dt 27 Maj 2010
1. Shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë, zonës së banimit, rajonit (qëndror, malor, bregdetar, Tirana urbane) dhe statusi ekonomik	%	INSTAT-LSMS		sa herë zhvillohet LSMS	√
2. Shkalla e varfërisë së skajshme sipas gjinisë, zonës së banimit, rajonit	%	INSTAT-LSMS		sa herë zhvillohet LSMS	√

(qëndror, malor, bregdetar, Tirana urbane) dhe statusi ekonomik					
3. Shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë së kryefamiljarit	%	INSTAT-LSMS		sa herë zhvillohet LSMS	√
4. Përqindja e femrave dhe meshkujve që marrin përfitimin e aftësisë së kufizuar	%	MPÇSSHB	INSTAT-LSMS	Vjetore dhe sa herë zhvillohet LSMS	√
5. Pensioni mesatar mujor sipas gjinisë zonës urbane / rurale	LEK	INSTAT i mbledhur nga ISSH		Vjetore	
6. Numri i kryefamiljarëve meshkuj dhe kryefamiljareve femra që marrin ndihmë ekonomike sipas rajonit	numri	MPÇSSHB		Vjetore	

Treguesit kryesorë të fushës nr. 5 sugjeruar që të mblidhen në të ardhmen				
Treguesit	Njësia e matjes	Burimi kryesor i të dhënave	Burimi dytësor i të dhënave	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave
1. Përqindja e femrave dhe meshkujve që aplikojnë për (a) përfitimet e aftësisë së kufizuar, dhe (b) shërbimet e mirëqenies, të ndara sipas llojit të shërbimit, moshës, nivelit arsimor, dhe vendbanimit (rurale / urbane)	%	MPÇSSHB mbledhur nga SSHS		Vjetore
2. Përqindja e femrave dhe meshkujve me aftësi të kufizuara që aplikojnë për shërbime sociale të ndara sipas llojit të shërbimit, moshës, nivelit arsimor, dhe vendbanimit (rurale / urbane)	%	MPÇSSHB mbledhur nga SSHS		Vjetore

ANEKS 2 - Lista e kontakteve për Organizata të Shoqërisë Civile

Qarku Kukës

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
1.	ALB-AID	Rr. Eksod 99, P. Drini, K.1/2, Kukës
2.	Gruaja në zhvillim - Kukës	Lagja Nr. 6, Vila pranë zjarrfikëses, Kukës
3.	Për ju Nëna dhe Fëmijë	Lagjja 6, Kukës
4.	Qendra Integrim e Zhvillim Demokratik Kukës (QIZHDK)	Lagja nr. 4, Pallati nr.8, Shk. 1, Ap 3, Kukës
5.	Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci (QDNJD) - Dega Tropojë	Sheshi A. Hajdari, Pallati i Kulturës, Bajram Curri, Tropojë
6.	Rinia në Sipërmarrjen e Lirë	Rr. Dituria, Qendra Rinore, prapa Hotel Gjalica, Kukës

Qarku Shkoder

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
7.	Gruaja Drejt Integritimit	Qendra Komunitare pranë Bashkisë, Pukë
8.	Gruaja Verilindore e Pa Punë	Angjelina Paloka, rruga "Migjeni" Pukë
9.	Madonnina Del Grappa	KUTIA POSTARE 181, Shkodër
10.	Projekti Shpresa	L.3 Heronj, Rr. Pal Engëlli, Nr 5, Shkodër
11.	Qendra Sociale "Hapa të Lehtë"	Rr. Murgeshave Nr 6, Shkodër
12.	Ravasco	Lagja "Tre Heronjtë", Rruga "Çajupi", Kutia Postare 152, Shkodër
13.	Shoqata e Gruas "Nora e Kelmendit"	Tamare, Malesi e Madhe
14.	Shpresa për të ardhmen	L: 3 Heronj, Rr: Skenderbeg, nr.63, Shkoder
15.	Trajnerë në Edukim	L. Fahri Ramadani, Rr. Tregu i ri. Ap. 259, Shkodër

Qarku Lezhe

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
16.	Gruaja Vizioni i Ndryshimit	Qendra e Artizanatit, Bulevardi Gjergj Fishta, Lezhe
17.	Komiteti Rinor Lezhë	Pallati Kulturës, Kati II, Lezhë

18.	Romët e Veriut (ReV)	Lagjia Skënderbeg, Lezhë
19.	Shoqata social kulturore "Shega lezhjane"	Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati 136, shkalla 13, Lezhë

Qarku Diber

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
20.	Bashkëpunim e Zhvillim të fshatrave të Qarkut të Dibrës (DELFINI)	Bulevardi Elez Isufi - QEK, Peshkopi
21.	Qendra Ditore Multidisiplinare MATI (QDMD)	QDMD "MATI" Pallati I Sportit "Ferit Hysa" Burrel
22.	Shoqata maqedonase "Ilinden"-Tiranë - Dega Gollobordë	Trebisht - Dibër

Qarku Durrës

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
23.	Fondacioni Instituti për Progres - Albania (INGPA)	Lagjia Nr 17, Rruga "Stef Kaculini" Nr 7790, Durrës
24.	Forumi rajonal I OJF-ve, Krujë	Lagja 2, Krujë
25.	Qendra ALBANIA	L. 13, Plazh, Durrës
26.	Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Durrës (QZSHHC)	Lagja 11, Rruga: A. Serreqi, Durrës
27.	Qendra Komunitare "Sot për të Ardhmen"	L. 17, Rr. "Leon Tolstoi", Skolina 5, ish-Kënetë, Durrës
28.	Shoqata e Grave me Probleme Sociale	L.2, Rruga "Sefer Efendiu", prapa Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës

Qarku Tirane

Nr.	Emri i OJF-së	Adresa
29.	Agjencia për Kërkime, Trajnime dhe Konsulencë (AKTK)	Rr. Hajredin Shtino, Nr. 44, Tiranë
30.	Aksion Plus	Qendra e shëndetit mendor Nr. 1, Rr. Stavri Vinjau, Tiranë
31.	Albanian Art Institute (AAI)	Rr. Muhamet Gjollësja, Blloku Vasil Shanto, Pall. Nr. 6, Ap. 7, Tiranë

32.	Albanian Center of Contemporary Art (ACCA)	Galeria e Vogel, P. 7, Ap 31, Tirane
33.	Albanian Legal and Territorial Research Institute (ALTRI)	Rruga "Asim Zeneli", Nr. 7, Tiranë
34.	Albanian Life Quality Union (ALQU)	Rr.Frederik Shiroka, Kulla C/3 Kati II, Tirane, Albania
35.	Art Kontakt	Rr. Luigj Gurakuqi, P.89/A, kati 10. (pranë R&T group), Tiranë
36.	ASAN (Rrjeti i Studentëve Shqiptarë në Botë)	Rr. Pjetër Bogdani, Nr. 16, Tiranë
37.	Balkan Youth Link Albania (BYL-A)	Rr. Myslym Shyri, P. 55, Shk. 1 Ap. 3, Tirane
38.	CARITAS Albania	Rr. Don Bosco, Nr. 4, Tiranë
39.	Dream City FEST	Rruga "Ibrahim Tukiqi", Nr. 6, 1001, Tiranë
40.	ECO - Partners for Sustainable Development	Rr. Ismail Qemali, Pallati 2K, Nr. 25/B, Tiranë
41.	Ecovolis	Rruga Dora D'Istria, Vila 1, Tiranë
42.	Ekolevizja	Rr. M. Shtylla Nd. 46, Ap. 26, Kodi Postar 1022, Tiranë
43.	Endra pa faj	Bul. "Zhan D'Ark", Pall.2, Shk.1, Ap.8, Tiranë
44.	Evolution of Youth	Rr. H.H.Dalliu, P. 10, Shk. 3, Ap.8, Tiranë
45.	Evropianet e Rinj Federaliste (JEF Albania)	Rruga Barrikadave, Pallati (Hodo) Ish-Kinema 17 Nentori, Hyrja B2, Nr. 6, Tiranë
46.	Fëmijët e shekullit 21	Bulevardi zogu i pare, pall.32, shk.1, Tiranë
47.	First Step (FS)	Rr. "Reshit Collaku", Pall. Shallvaret, Tiranë
48.	Fondacioni "Davidi"	Rruga "Sulejman Delvina", Nd. 46, Ap. 1, Tiranë
49.	Fondacioni "Harriet Martineau"	Rruga e Dibrës, Pall 110. Pranë Klinikës Ortodokse, Tiranë
50.	Fondacioni për Liri Ekonomike (FLE)	Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H. 1, Njësia Bashkiake Nr. 7, Kodi Postar 1023, Tiranë
51.	Fondacioni për Zhvillim Humanizëm dhe Demokraci (FZHHD)	Rruga: "Pjetër Budi", 271, Tiranë

52.	Fondacioni Praktikimi i Gjuhës	Rr. "BARDHYL", Nr. 82, H1, Tiranë
53.	Fondacioni ROZAF	Rr.Vace Zela 19, Tirane
54.	Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile	Blvd. Gj. Fishta, Kulla 1, H.1, Kati 6, Apt.26, Tiranë
55.	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK - ARDF)	Rr. "Bogdani", Nr. 1, Tiranë
56.	Fondacioni Ulysses	Bulevardi Dëshmorët e Kombit, pranë Hotel Rogner Europapark, Tiranë
57.	Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve	Rruga "Him Kolli", Pall. Fratari, Ap.2-C, Tiranë
58.	Fondacioni CIVITAS Albania	Rr. Barrikadave Hyrja B nr.07, p.o.box 10.000 Tirane, Shqiperi
59.	FORIS	Rr. Ali Demi, Tiranë
60.	Forumi i Mendimit të Lirë	Rr. Artan Lenja, Pallati 6, Ap. 13, Laprakë, Tiranë
61.	Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare	Rr. "Brigada e VIII", pallati Teknoprojekt, Sh. 1/29, Tiranë
62.	Forumi Shqiptar për Aleancën e Qytetërimeve (AFALC)	Bulevardi "Zogu i I", Pallati 12-katësh (pranë godinës ZP) P.O. Box 8347, Tiranë
63.	Forumi Shqiptar Social Ekonomik (ASET)	Rr."Ismail Qemali", Pall. 27/1 Shk.2, Apt.13, P.O. Box 1506, Tiranë
64.	Gra të Reja në Aksion (GRA)	Rr. Brigada VIII, pall. Teknoprojekt, ap.29, Tiranë
65.	Gratë në ndihmë të komunitetit	Rruga "Sulejman Delvina" Pall 142/3, ap 12, Tirane
66.	Green Line Albania	Rruga "Sulejman Delvina", pranë Stadiumit "Selman Stërmasi", Tiranë
67.	Gruaja në Muzikë	Rr. "Him Kolli", Pall. ALDE 2 Shk B, Ap. 22, Tiranë
68.	Gruaja në Zhvillim	Rr. A. Frashëri, P. 9, Sh. 5, Ap. 42, Tiranë
69.	Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ)	Rr. Ibrahim Rugova (ish - Rr. 4 Shkurti), P.7/1. Shk.2, Ap.30, Tiranë
70.	Hapësirat e Jetës	Rr. Myslym Shyri, P 3/1, Tiranë
71.	Henry Dunant	Rruga "Hoxha Tasim, pallati 288, shkalla 2, ap 15, Tiranë

72.	Hope and Homes (H&H)	Rr. Ali Visha, Nr. 4, Tiranë
73.	iBbY-Shtëpia e Librit për Fëmijë dhe të Rinjtë "Hermann Gmeiner" - Bibliotekë	Rr. Jordan Misja, (Unazë), te konvikti i shkollës elektrike, Tiranë
74.	INIS ART (IA)	"Sheshi Gjeneral Jozef San Martini" P 9-10, Tirane
75.	Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik (IPSED)	Rr. Asim Zeneli nr. 11 Tiranë
76.	Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri (INLSH - ICLA)	Rr. Frang Bardhi, Qendra Kristal, Godina B, Ap 3/13, Tiranë
77.	Instituti AKT (Instituti Shqiptar i Kulturës dhe Arteve)	Rr. "Hoxha Tahsin", Nr. 181, Tiranë
78.	Instituti i Kërkimeve e Studimeve Gjinore (IKSGJ)	Rruga Brigada VIII, në oborrin e pallateve Agimi, 11/5, Tiranë
79.	Instituti i Kërkimeve Rurale	Kutia Postare nr 139, Tiranë
80.	Instituti i Kërkimeve Urbane	Rr. Reshit Petrela (Pranë Arkivës së Shtetit), Sek. 1, Kati 9, Ap. D, Tiranë
81.	Instituti i Komunikimit Social (IKS)	Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kulturës, Kati III, Tiranë
82.	Instituti i Menaxhimit të Fermave & Agrobiznesit (IMFA)	Universiteti Bujqësor, Fakulteti i Ekonomisë & Agrobiznesit, Kamëz, Tiranë
83.	Instituti i Parandalimit të Krimit	Rr. M.Gjollësja, pranë shtëpisë botuese "Toena", Tiranë
84.	Instituti i Studimeve Bashkëkohore (ISB)	Rruga "Vaso Pasha", Nr. 7, Tiranë
85.	Instituti i Studimeve të Opinioneve Publik (ISOP)	Rr. "Muhamet Gjollësja" Pall: 241/5, Tiranë
86.	Instituti Kërkimor - Shkencor BARLETI	Rr. "Sami Frashëri" Nr. 41, Pranë Liqenit Artificial, Tiranë Shqipëri
87.	Instituti Menaxhimit & Integritetit Mjedisor (IMIM)	Rruga e "Durrësit", Pll. 118, Nr. 2, Tiranë
88.	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)	Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 37, P. O. BOX 8177, Tiranë
89.	Instituti për Mirqënie dhe Ambjent (IMA)	Numër 355, Rr. "Theofan Popa" Lagje Nr. 1, Tiranë
90.	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)	Rruga "Islam Alla", Nd. 3, H 13, 1001, Tiranë
91.	Instituti për Studime Gjyqësore dhe Kushtetuese (ISGjK)	Universiteti Illyria, Tiranë

92.	Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL)	Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Kati VII, Tiranë
93.	Instituti Shqiptar i Marrëdhënieve Publike (AIPR)	Rr. "Kavajes" Qendra "Gurten" 107/110, Tiranë
94.	Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)	Rruga "Hodo Beg", Pallati 12-katësh, ap 24, Tiranë
95.	Instituti Shqiptar i Studimeve dhe Edukimit në Teknologjine e Informacionit (ISSETI)	Rr. "George W. Bush", përballë Parlamentit, Kulla II, Tiranë
96.	Instituti Shtëpia e Drejtësisë dhe e Pajtimit Kombëtar	Bulevardi Zogu i Pare Prane stacionit te trenit Tirane
97.	Integrimi i Zonave Suburbane (IZS)	Rruga "Gj. Legisi", Laprakë, Tiranë
98.	Jetimët në Fokus	Njesia 6, Rr "LL.Bonata". p.8, Shk. 3/30 Tiranë
